

## **X GJYQËSIA**

### **NOCIONET KRYESORE:**

**Pushteti gjyqësor; Gjykatat themelore; Gjykatat e apelit; Gjykata e lartë; pavarësia e Gjykatave; verbaliteti në gjykim; publiciteti; funksioni i përhershëm gjyqësor; inkopatibiliteti; imuniteti; gjyqtarët porotë; Këshilli gjyqësor republikan.**

### **PYETJE:**

- 1. Cilat lloje të gjykatave ekzistojnë në RM-së?**
- 2. A ekzistojnë gjykata të jashtëzakonshme në RM-së?**
- 3. Në cilat raste mund të shkarkohet gjyqtari?**
- 4. Kush i zgjedh dhe i shkarkon gjyqtarët?**
- 5. Kush i zgjedh dhe i shkarkon gjyqtarët porotë?**
- 6. Kush i propozon gjyqtarët?**
- 7. Kush i propozon gjyqtarët porotë?**
- 8. Për sa kohë zgjidhen gjyqtarët??**
- 9. Për sa kohë zgjidhen gjyqtarët porotë?**
- 10. Ç'është publiciteti në gjykim?**
- 11. Ç'është verbaliteti në gjykim?**
- 12. Ç'është pavarësia e gjykatave?**
- 13. Ç'është imuniteti gjyqësor??**
- 14. Çfarë përfshin inkopatibiliteti i funksionit të gjyqtarit?**
- 15. Çfarë të drejtash kanë gjyqtarët?**
- 16. Kush e zgjedh Këshillin gjyqësor republikan?**
- 17. Sa zgjat mandati i anëtarëve të Këshillit gjyqësor republikan?**
- 18. Çfarë kompetencash ka Këshilli i gjyqësor republikan?**

## 1. Pozita dhe organizimi i sistemit gjyqësor në Republikën Maqedonisë

Në kuadër të ndarjes së funksioneve shtetërore, funksioni gjyqësor është lënë në kompetencë të gjykatave. Pushteti gjyqësor është kompetent për zgjidhjen e kontesteve juridike, të tregojë se çfarë është në pajtim më të drejtën në rastin konkret. Funksioni gjyqësor, si funksion gjyqësor i zgjidhjes së kontesteve të cilat paraqiten ndërmjet pjesëtarëve të një shteti, është i vjetër. Por, pushteti gjyqësor si institucion shtetëror daton më vonë.

Në teori ekzistojnë dilema se a mund të flitet për pushtet gjyqësor, përkatësisht a mund të flitet për gjykatat si pushtet i tretë. Dilemat dalin, para se gjithash, nga fakti që shpeshherë gjykatat gjenden në pozicion varësie nga pushteti legjislativ, parasëgjithash nga pushteti ekzekutiv. Pavarësia e gjykatave është parakusht esencial për konstituimin e pushtetit gjyqësor si pushtet i përgatitur që të “ballafaqohet” me dy pushtetet e tjera në shtet.

Gjykatat në RM-së gjykojnë në bazë të Kushtetutës, ligjeve dhe në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe sigurojnë zbatimin e të drejtës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Objektivat dhe funksionet e gjyqësisë përfshijnë: zbatimin e paanshëm të së drejtës, pa marrë parasysh pozitën dhe cilësinë e palëve; përparimin e mbrojtjes dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut; sigurinë juridike dhe krijimin e kushteve për çdo njeri të jetojë i sigurt në kuadër të zbatimit të së drejtës.

Gjykata vendos sipas procedurës së shkruar ligjore për: të drejtat e qytetarëve dhe interesat të bazuara juridike; kontestet ndërmjet qytetarëve dhe subjekteve të tjerë juridik; veprat e dënueshme dhe veprimet e tjera që me ligj janë lënë nën kompetencën e gjykatës.

Organizimi i gjyqësisë në Republikën e Maqedonisë është unitar. Gjykatat e jashtëzakonshme janë të ndaluara. Llojet, kompetencat, themelimi, anulimin?, organizimi dhe përbërja e gjykatave është rregulluar me Ligjin për gjykatat (1). Ky është ligj organik, ligj që sillet me shumicë të cilësuar prej dy të tretave të votave nga i gjithë numri i deputetëve.

Në sistemin unitar gjyqësor, pushtetin gjyqësor e ushtrojnë *gjykatat themelore, gjykatat e apelit dhe Gjykata e lartë e RM-së*.

*Gjykatat themelore krijohen për territore të caktuara.* Në RM ekzistojnë 72 gjykata themelore. Gjykatat themelore mund të gjykojnë edhe jashtë selisë së gjykatës në ditët gjyqësore. Gjykatat themelore janë kompetente të vendosin në shkallë të parë për çështje në kompetencë gjyqësore, për veç çështjeve të cilat me ligj i janë lënë një gjykate tjetër. Gjykatat janë kompetente për gjykimin në shkallë të parë të procedurës penale, për delikte ekonomike, pronësore dhe kontestet juridiko-civile e kështu me radhë. Gjykatat themelore janë kompetente të vendosin në shkallë të parë edhe për

çështjet jashtëprocedurale, ekzekutimin dhe sigurimin edhe për vërtetimin e tapive dhe intabulacionet, në qoftë se me ligj nuk është përcaktuar kompetenca e organit ose institucionit tjetër. Gjykatat themelore janë kompetente të vendosin në shkallë të parë edhe për kundravajtjet, përderisa me ligj nuk është caktuar që për lloje të caktuara të kundravajtjeve të vendosin organe të tjera ( doganore, devizore, të tregtisë me jashtë dhe tatimet ).

*Gjykatat e apelit* krijohen për territoret e më shumë gjykatave themelore. Në RM ekzistojnë 3 Gjykata apeli: në Manastir, Shkup dhe në Shtip. Gjykatat e apelit janë kompetente të vendosin mbi ankesat kundër vendimeve të gjykatave themelore, të vendosin për mosmarrëveshjen e kompetencës ndërmjet gjykatave themelore në territorin e tyre dhe të kryejnë veprime të tjera të përcaktuara me ligj.

*Gjykata e lartë* e RM-së ushtron pushtetin gjyqësor në të gjithë territorin e Republikës. Ajo është gjykata më e lartë në Republikë dhe e siguron unitetin në zbatimin e ligjeve nga ana e gjykatave. Selia e saj është në Shkup. Gjykata e lartë është kompetente të vendosë në shkallë të dytë kundër vendimeve të këshillave të saja kur kjo është e përcaktuar me ligj; vendos në shkallë të tretë dhe përfundimisht mbi ankesat kundër vendimeve të gjykatave të apelit dhe kundër vendimeve të këshillave të saja të sjella në shkallë të dytë kur kjo është e përcaktuar me ligj; vendos në shkallë të parë dhe shkallë të dytë në kontestet administrative kur kjo është përcaktuar me ligj dhe vendos për vendimet përfundimtare të sjella në procedurën e kundravajtjeve; vendos për mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të plotëfuqishme të gjykatave dhe vendimeve të këshillave të saja kur kjo është përcaktuar me ligj; vendos për mosmarrëveshjen e kompetencës ndërmjet gjykatave themelore të territoreve të ndryshme të gjykatave të apelit, ndërmjet gjykatave të apelit dhe vendos për delegimin e kompetencës vendore te këto gjykata. Gjykata e lartë për mjetet juridike vendos në këshill të përbërë nga 5 gjyqtarë, në qoftë se me ligj tjetër nuk është përcaktuar ndryshe. Gjykata e lartë në seancë të përgjithshme; përcakton qëndrime parimore dhe mendime parimore juridike për çështjet me rëndësi për sigurimin e unitetit në zbatimin e ligjeve nga ana e gjykatave; jep mendim për propozimet e ligjeve dhe rregullave të tjera kur me to rregullohen çështje me rëndësi për veprimtarinë e gjykatave; shqyrton çështje në lidhje me veprimtarinë e gjykatave, zbatimin e ligjeve dhe praktikën gjyqësore; sjell rregullore për veprimtarinë e gjykatës; sjell programin për veprimtarinë e gjykatës; vërteton mendimin për zgjedhjen dhe ekzistimin e shkaqeve për largimin e gjyqtarit; vendos mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimeve të këshillave të saja dhe shqyrton raportin për veprimtarinë e vet dhe raportet për veprimtarinë e gjykatave të tjera.

## 2. Parimet kushtetuese të Gjykatave

Kushtetuta e RM-së përmba disa parime që kanë të bëjnë me organizimin e veprimtarisë së Gjykatave dhe me statusin e Gjykatave.

1. *Pavarësia e Gjykatave.* Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë proklamon se Gjykatat janë organe shtetërore të pavarura. Gjatë vendosjes mbi gjyqëtarin nuk

mund të bëhet asnjë farë lloj kufizimi, ndikimi, motivimi, presion, kërcënimi ose ndërhyrje të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë, nga cilido subjekt qoftë ose për çfarë do lloj arsye qoftë. Askush nuk ka të drejtë ta kufizojë ose pengojë të drejtën e gjyqtarit që ta shpallë vendimin. As me ligj, as me akt të pushtetit ekzekutiv nuk mund të lejohet të rishqyrtimi i vendimeve gjyqësore ose të ndryshohet përbërja e gjykatës për arsye të ndikimit mbi gjykatën. Çdo organ shtetëror është i detyruar të përmbahet nga të kryerit ose nga lejimi i ndonjë veprë me të cilën do të pengohet sjellja e vendimit gjyqësor ose ekzekutimi i tij.

**2. Publiciteti.** Shqyrtimi pranë gjykatave dhe shqiptimi i aktgjykimit është publik. Publiciteti i gjykimit do të thotë, për veç palëve, në gjykim mund të marrin pjesë edhe persona të tretë të cilët nuk kanë interes konkret në procesin gjyqësor. Qëllimi i publicitetit është që ai të jetë një farë garance kundër keqpërdorimeve në gjykim; një numër më i madh njerëzish të njoftohen me përmbajtjen e rregullave juridike; të shërbejë si nxitje për gjyqtarët që ata të veprojnë sipas rregullave. Publiciteti mund të përjashtohet në raste të përcaktuara me ligj ( p.sh. për shkak të ruajtjes së sekretit shtetëror, për shkak të mbrojtjes së moralit, për shkak të mbrojtjes së interesave të të miturve etj ).

**3. Verbaliteti në gjykim.** Ky parim do të thotë Gjykata gjykon në *këshill*. Qëllimi është të sigurohet vlerësimi i gjithanshëm i gjendjes faktike. Por, ky nuk është parim absolut, por me ligj përcaktohet se kur gjyqtari gjykon vetë.

**4. Pjesëmarrja e qytetarëve në gjykim.** Kjo do të thotë që, për veç gjyqtarëve profesionist, në gjykim marri pjesë edhe persona joprofesionist, laik. Në gjykim marri pjesë dhe gjyqtarët porotë, kur kjo është e përcaktuar me ligj.

**5. Palëvizshmëria e funksionit të gjyqtarit.** Parimi i palëvizshmërisë së funksionit të gjyqtarit do të thotë që gjyqtari zgjidhet për një kohë të pacaktuar, që do të thotë se ai nuk i nënshtrohet rizgjedhjes periodike. Kjo u jep atyre pavarësi më të madhe në ushtrimin e detyrës. Gjyqtari mund të shkarkohet vetëm në raste konkrete të përcaktuara me Kushtetutë.

**6. Imuniteti i gjyqtarit.** Gjyqtarët gëzojnë imunitet. Gjyqtari nuk mund të merret në përgjegjësi për mendimin dhe vendosjen gjatë sjelljes së vendimeve gjyqësore. Gjyqtari nuk mund të arrestohet pa autorizimin e kuvendit të RM-së, për veç se nëse është kapur në kryerjen e veprës penale për të cilën është parashikuar dënimi me burg më së paku 5 vjet. Procedura e vendosjes për imunitetin të gjyqtarit është e përsheptuar dhe zbatohet pas marrjes së mendimit paraprak nga Këshilli gjyqësor Republikan.

**7. Inkopatibiliteti i funksionit të gjyqtarit.** Funksioni i gjyqtarit është i papajtueshëm me asnjë funksion tjetër publik, profesion ose me anëtarësim në ndonjë politike. Gjyqtëri, sipas Ligjit për gjykatat, mund të mbajë ligjerata në universitet dhe të marr pjesë në projekte të caktuara shkencore pranë universitetit, pa të drejtën e shpërblimit.

### 3. Statusi i gjyqtarëve dhe i gjyqtarëve porotë në Republikën e Maqedonisë

#### 3.1. Gjyqtarët

Funksionin gjyqësor e ushtrojnë gjyqtarët. Funksionin gjyqësor gjyqtari e ushtron në gjykatën në të cilën është zgjedhur. *Gjyqtarët i zgjedh dhe i shkarkon Kuvendi i RM-së, me propozim të Këshillit gjyqësor Republikan.* Kuvendi I RM-së e shpall zgjedhjen e gjyqtarëve për gjykatën përkatëse në “Gazetën zyrtare të RM-së” dhe në shtypin e përditshëm më së voni 15 ditë nga dita e marrjes së vendimit për evidentimin e numrit të gjyqtarëve. Me shpalljen njoftohen kandidatët e interesuar në afat prej 15 ditëve nga dita e shpalljes në “Gazetën zyrtare të RM-së” ti dorëzojnë fletëparaqitjet në Këshillin gjyqësor Republikan. Gjyqtari zgjidhet *pa kufizimin e zgjatjes së mandatit.* Gjyqtari mund të shkarkohet vetëm në këto raste:

- kur këtë vetë e kërkon;
- në qoftë se përgjithmonë e humb aftësinë për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit, që e vërteton Këshilli gjyqësor Republikan;
- në qoftë se i plotëson kushtet për pensionim të parakohshëm;
- në qoftë se është dënuar për vepër penale të kryer me dënim burgim pa kusht më së paku gjashtë muaj;
- për shkak të shkeljes së rëndë disiplinore që e bën të padenjë për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit. Si shkelje e rëndë disiplinore konsiderohet: prishja e rendit dhe qetësisë publike me të cilën cënon autoritetin e tij dhe autoritetin e gjykatës; aktivitetet partiake dhe politike; ushtrimi i funksionit publik ose ndonjë profesioni; shkaktimi i prishjes së rëndë të marrëdhënieve në gjykatë të cilat ndikojnë në ushtrimin e funksionit të gjyqtarit; shkelja e rëndë e të drejtave të palëve dhe të pjesëmarrësve të tjerë në procedurë me çka cënohet autoriteti i gjykatës dhe i funksionit të gjyqtarit;
- për shkak të ushtrimit në mënyrë të pandërgjegjshme dhe joprofesionale të funksionit të gjyqtarit, që e vërteton Këshilli gjyqësor Republikan.

Para marrjes së detyrës gjyqtari jep deklaratë solemne para kryetarit të Kuvendit të RM-së.

Gjyqtarët gjatë mandatit të tyre kanë të drejta dhe detyrime të caktuara.

Për veç atyre që janë theksuar më lartë ( imuniteti, pavarësia e funksionit të gjyqtarit ), si të drejta të veçanta të gjyqtarëve në ushtrimin e funksionit të gjyqtarit konsiderohen: e drejta e kalimit të stacioneve?, aeroporteve, porteve, vetëm me kallëzimin e dokumenteve të identifikimit; e drejta e lejes zyrtare për armëmbajtje dhe municion adekuat; e drejta e mbrojtjes së veçantë të personalitetit të tyre, të familjes dhe pasurisë me kërkesën e tyre drejtuar policisë në vendbanim, gjithmonë kur ekzistojnë arsye serioze për sigurinë e tyre etj.

Gjyqtari në lidhje me ushtrimin e funksionit të gjyqtarit nuk mund të marrë dhurata nga palë ose nga persona të cilët në mënyrë direkte ose indirekte kanë interes në gjykim.

Kundër gjyqtarit nuk mund të niset procedurë për dëmshpërblim ose ndonjë procedurë tjetër nga ana e palës që nuk është e kënaqur nga vendimi gjyqësor. Për dëmin që gjyqtari, në ushtrimin e funksionit, do t'ua shkaktojë qytetarëve ose personave juridikë me punë të kundraligjshme, përgjegjës është Republika e Maqedonisë.

Gjyqtari nuk mund të transferohet nga një vend, në tjetër kundër dëshirës së tij.

### 3.2. Gjyqtarët porotë

*Gjyqtarët porotë i zgjedh dhe i shkarkon Kuvendi i RM-së me propozim të Gjykatave themelore dhe Gjykatave të apelit.* Për gjyqtar porotë mund të zgjidhet shtetasi madhor i RM-së me arsimim më së paku të mesëm, që gëzon autoritet për ushtrimin e këtij funksioni. Gjyqtari porotë për gjykimin e të miturve duhet të jetë person me përvojë më të gjatë në fushën e edukimit dhe arsimimit të të rinjëve. Gjyqtari porotë zgjidhet për një kohë prej katër viteve dhe mund të zgjidhet përsëri. Përpara fillimit në detyrë, gjyqtarët porotnik japin deklaratat solemne para kryetarit të Gjykatës në të cilën janë zgjedhur. Gjyqtarët porotë nuk mund të merren në përgjegjësi për mendimin dhe vendimin gjatë sjelljes së vendimeve gjyqësore.

Gjyqtari porotë shkarkohet nga detyra në qoftë se: këtë vetë e kërkon; kur e humb përgjithmonë aftësinë për ushtrimin e detyrës së Gjyqtarit porotë; kur është dënuar me burg, së paku 6 muaj.

## 4. Këshilli Gjyqësor Republikan

1. Këshilli gjyqësor republikan është organ i ri i parashikuar në Kushtetutën e RM-së në vitin 1991, me qëllim që të kontribuojë në forcimin dhe realizimin e funksionit gjyqësor dhe të sigurojë pavarësin e gjykatave, pa ndërhyrë në punët e tyre. Këshilli gjyqësor republikan nuk është gjykatë, por është organ i pavarur me fushëveprim të përcaktuar nga Kushtetuta.

2. *Përbërja dhe mandati.* Këshilli gjyqësor republikan përbëhet nga 7 anëtarë të cilët i zgjedh Kuvendi nga rradhët e juristëve të shquar. Në procesin e propozimit të anëtarëve të Këshillit gjyqësor republikan marin pjesë: Presidenti i Republikës i cili propozon dy anëtarë dhe Kuvendi, përkatësisht komisioni parlamentar për zgjedhje dhe emërimë, i cili propozon pesë anëtarët e tjerë të Këshillit gjyqësor republikan. Në pajtim me Amendamentin XIV, tre anëtarë të Këshillit gjyqësor republikan zgjidhen me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve, gjatë së cilës patjetër duhet të ketë shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u përkasin bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

Mënyra e këtillë e propozimit dhe e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit gjyqësor republikan lë hapësirë të ndikimit politik mbi organin i cili duhet të jetë mbrojtësi i pavarësisë së gjyqësisë. Në të drejtën e krahasuar kushtetuese ekzistojnë zgjidhje më të

mira që sigurojnë ndikim më të madh të gjyqtarëve mbi zgjedhjen e anëtarëve të këtij organi. Për shembull në Republikën e Sllovenisë, Këshilli gjyqësor është i përbërë prej 11 anëtarëve, 5 prej të cilëve me propozim të presidentit të shtetit i zgjedh Parlamenti. Sipas Kushtetutës, ata zgjidhen nga radhët e profesorëve universitarë të së drejtës, avokatëve dhe juristëve të tjerë. Gjashtë anëtarët e tjerë, gjyqtarët i zgjedhin nga radhët e tyre. Do të thotë se në Slloveni shumica e anëtarëve të Këshillit gjyqësor janë gjyqtarë të zgjedhur nga ana e të gjithë gjyqtarëve. Në Republikën e Maqedonisë, gjyqtarët nuk kanë asnjë farë ndikimi mbi zgjedhjen e Këshillit gjyqësor republikan.

Anëtarët e Këshillit gjyqësor republikan në Republikën e Maqedonisë zgjidhen me mandat prej 6 viteve me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Këshilli nga anëtarët e tij zgjedh kryetarin e Këshillit për një kohë prej 3 vjetëve, pa të drejtën e rizgjedhjes.

Anëtarit të Këshillit gjyqësor republikan i ndërpritet funksioni në qoftë se jep dorëheqje. Anëtari i Këshillit gjyqësor republikan mund të shkarkohet nga funksioni në qoftë se është dënuar për vepër penale të dënimit me burgim pa kusht më së paku 6 muaj ose kur përgjithmonë e humbë aftësinë për të ushtruar funksionin e tij, që e vërteton Këshilli mbi bazën e konstatimit dhe mendimit të komisionit shëndetësor kompetent.

*E drejta e imunitetit.* Anëtarët e Këshillit gjyqësor Republikan gëzojnë imunitet. Për imunitetin e tyre vendos Kuvendi.

**4. Inkopatibiliteti.** Funksioni i anëtarit të Këshillit Gjyqësor Republikan është inkopatibil me kryerjen e ndonjë funksioni ose profesioni tjetër publik ose me anëtarësimin në parti politike.

**5. Kompetenca.** Këshilli gjyqësor republikan:

- i propozon Kuvendit të RM-së zgjedhjen dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe vërteton kërkesën për shkarkimin nga funksioni të gjyqtarit në rastet e përcaktuara me Kushtetutë;
- vendos për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve. Këshilli ngre procedurë për vërtetimin e përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarit kur ekziston dyshimi i bazuar se gjyqtari ka kryer shkelje të rëndë disiplinore të parashikuar me ligj që e bën të padenjë për kryerjen e funksionit të gjyqtarit. Para ngritjes së procedurës, Këshilli do të kërkojë nga gjyqtari të deklarohet për dhënien e provave dhe propozimit për fillimin e procedurës. Propozimin për ngritjen e procedurës për vërtetimin e përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarit mund ta paraqesë kryetari i gjykatës, kryetari i gjykatës më të lartë dhe seanca e përgjithshme e Gjykatës së lartë; e vlerëson profesionalizmin dhe ndërgjegjshmërinë e gjyqtarëve në ushtrimin e funksionit gjyqësor;
- propozon dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të RM-së.

